



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT

DATË /A	07.12.2016
REFERENCË	
PËR:	z. Imri Ahmeti, Kryetar i Komunës në Lipjan
CC:	z. Fitim Selimi, Nënkyetar i Komunës në Lipjan z. Sefer Tasholli, Nënkyetar i Komunës në Lipjan
NGA:	z. Rasim Hasani, Drejtor i Drejtorisë së Arsimit në Lipjan
LËNDA:	Raport i punës – Muaji Nëntor 01.11.2016-30.11.2016

DKA edhe gjatë muajit Nëntor ka realizuar punë dhe aktivitete të ndryshme dhe ato:

Furnizimi i shkollave të reja me inventar:

- Shfmu “Nezë Bujani” në Bujan dhe
- Shfmu “Emin Duraku” në Banullë p,n,f në Bujari.

Furnizimi i shkollave me lëndë djegëse - qymyr.

Për nderë të festës së 28 Nëntorit janë realizuar aktivitete të ndryshme në të gjitha shkollat fillore dhe ato të mesme.

DKA në bashkëpunim me OSBE-në dhe Shfmu “Ismail Luma” në Lipjan në kuadër të fushatës **“Stop dhunës ndaj gruas”** ka realizuar aktivitete me nxënësit dhe mësuesit e shkollës “Ismail Luma” në Lipjan.

Ka vazhduar trajnimi për mësuesit e shkollave fillore - Mësues klase (1-5) për lëndët: Matematikë dhe Shkencat e Natyrës.

Nga projekti i Binjakëzimit është mbajtur trajnimi mbi komponentin e “Shëndetit dhe Mirëqenies” për mësuesit dhe arsimtarët e lëndës së edukatës fizike.

Në kuadër të programeve trajnuese për shkolla rreth Strategjisë për sigurimin e cilësisë në Arsimin Parauniversitar në Kosovë 2016-2020, kanë vazhduar trajnimin për cilësi shkollat: Shfmu "Ismail Luma" në Lipjan, Shfmu "Nezë Bujani" në Bujan, Shfmu "Kadri Beba" në Ribar i Madh, Shfmu "Skenderbeu" në Kraishtë dhe SHML-Shalë

Kërkesë KEDS-it për intervenim të shpejtë në rrjetin e tensionit të lartë në Shfmu "Rexhep Akllapi" në Akllap.

Përgatitja e formularëve të personelit arsimor dhe dërgimi i tyre në MSHP dhe ate:

- Formular për ndryshime - kthim nga lehonja, kalimi në pushim lehonie, shtimi i licencimit,
- Formular për largim - skadim kontrate, pensionim,
- Formular për punëtor të rinjë,
- Të ndryshme - ndërrim i xhirollogarisë.

Përmbyllja e zotimeve & Nënaloqimi i pagave.

Pranimi dhe shqyrtimi i kërkesave të ndryshme.